



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.12.2014; ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Votimi në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”.
2. Projektligji “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”
3. Projektligji “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri dhe Eduard Halimi.

Të ftuar:

Dritan Dango – këshilltar për marrëdhëniet me parlamentin në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinise

Denada Seferi – drejtoreshë e Përkujdesit Shoqëror në Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Merita Xhafaj - drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave Sociale

Nikolin Berxhiku - specialist në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Eni Culli - specialist në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Mimi Kodheli - ministre e Mbrojtjes

Zyber Dushku - komandant i Forcave Tokësore

Yllka Lamçe - drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Mbrojtjes

Ergys Dako – përfaqësues nga Policia Ushtarake

Ervin Kurti - përfaqësues nga Policia Ushtarake

Ingrid Vorfi - përfaqësues nga Policia Ushtarake

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen. Pika e parë e rendit të ditës është projektligji “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Fillimisht do të kemi një paraqitje nga ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli, e cila është e pranishme sot në komision. Pastaj do të vazhdojë relatori dhe në vazhdim kolegët deputetë.

Zonja Ministre, do të donim një prezantim të përmbledhur për qëllimin e projektligjit, si dhe për përmbajtjen e tij.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve,

Më lejoni sot të paraqes përpara jush projektligjin “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, projekt i cili ka për qëllim forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandimit, me qëllim kontrollin sa më të mirë të Forcave të Armatosura për të siguruar përmbushjen më së miri të misionit të saj kushtetues. Nevoja për hartimin e këtij projektligji lindi pasi ligji aktual nr.9183 daton 10 vjet më parë dhe normalisht konstatimi i një numri të madh problemesh që lidhen me këtë temë përgjatë kësaj periudhe na çoi në nevojën për ta riparë dhe një herë këtë ligj, si dhe për të mundësuar trajtimin sa më të mirë të shkeljeve disiplinore të para të verifikuara në vite apo në moszbatim të ligjit ekzistues.

Mangësitë e ligjit aktual, normalisht ne jemi munduar që t’i paraqesim më së miri në këtë projektligj të ri duke saktësuar më së pari autoritetet përgjegjëse për dhënien e masave, si dhe procedurat më të mirëpërcaktuara për të ndjekur zbatimin e procedimeve disiplinore. Risitë e këtij projektligji janë të shumta si qoftë nga forma, e cila iu është përshtatur më mirë normave të sotme të teknikës legjislative ashtu dhe nga përmbajtja e tij. Do të përmend disa nga ndryshimet kryesore duke filluar me autoritetet, të cilat kanë të drejtën e dhënies së masës disiplinore. Këto autoritete janë të detajuara në mënyrë të imtësishme duke eliminuar formulime të përgjithshme që ligji ekzistues ka për të shmangur dhe konfuzionin e krijuar nga praktikat e ndjekura në zbatim të ligjit ekzistues, si dhe në mirëpërcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore konkrete. Autoritetet që në këtë rast kanë të drejtën ta bëjnë këtë gjë fillojnë me

Presidentin e Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Kryeministrin, ministrin e Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e forcave dhe të strukturave mbështetëse, komandantët në nivel batalioni dhe komandantët në nivel kompanie.

Janë shtuar disa shkelje disiplinore. Ndër këto mund të përmend disa prej tyre, shkelje disiplinore me karakter politik, siç është mbështetja e fushatave të një partie politike ose të një organizate politike, ndihma, përkrahja dhe pjesëmarrja në aktivitete të organizatave politike, fetare ose jo fitimprurëse gjatë orarit të punës apo në vendin e punës, shkeljet e disiplinës që shënojnë figurën dhe dinjitetin e ushtarakut, si përdorimi i pijeve alkoolike gjatë orarit të punës apo përdorimi dhe shfrytëzimi i korrespondencës zyrtare për qëllime private e kështu me radhë. Shkeljet disiplinore që lidhen me mbajtjen dhe përdorimin e armëve të paautorizuar ose mosraportimin e përdorimit të armës, shkelje disiplinore që lidhen me administrimin e informacionit dhe dokumentacionit me karakter ushtarak ose që ka në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë lidhje me aktivitetin dhe veprimtarinë e Forcave të Armatosura, siç është publikimi apo dhënia në media e informacioneve që lidhen me veprimtarinë e Forcave të Armatosura, që lidhen me dokumentacion të klasifikuar, fshehja, ndryshimi apo asgjësimi i dokumentacionit zyrtar në formë shkresore apo elektronike.

Pra, të gjitha këto fenomene të vërejtura gjatë këtyre viteve, si dhe shkeljet disiplinore të tjera që kanë objekte të ndryshme, siç mund të jenë ngacmimet seksuale apo shkelje të tjera të shkaktuara të cilat në fakt janë të shkruara, të sanksionuara edhe në ligjet e disiplinës në shumë vende anëtarë të NATO-s. Gjithashtu pirja e duhanit në ambiente të ndaluara me ligj e kështu me radhë.

Në fakt, më lejoni të bëj një koment që me të drejtë përpara se sa të fillonim këtë mbledhje të komisionit disa kolegë më sugjeruan që, meqenëse pirja e duhanit në ambiente publike është e sanksionuar në një ligj tjetër, mundet që kjo të shikohet, pra mund t'i referohemi atij ligji tjetër dhe nuk është e nevojshme që këtë ta sanksionojmë edhe në ligjin e disiplinës ushtarake.

Parashikimi i masave që duhen marrë. Mendoj se për sa u përket masave disiplinore ato janë ndarë në të lehta, të rënda dhe shumë të rënda. Dy llojet e para kanë qenë të parashikuara edhe në ligjin ekzistues. Janë shtuar vetëm shkeljet shumë të rënda,

e cila është një risi tjetër e këtij projektligji. Dhënia e masave disiplinore nga autoritetet civile në fakt është një tjetër risi e këtij ligji. Ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Presidenti i Republikës janë autoritetet civile të cilat mund të japin masa disiplinore. Një zgjidhje e tillë është bërë me qëllim që çdo ushtarak i Forcave të Armatosura qoftë ky ushtar i thjeshtë apo shefi i shtabit të përgjithshëm të Forcave të Armatosura të jetë i detyruar të ndjekë ligjin dhe të jetë i detyruar ta respektojë atë deri në një nëpërmjet njësive të caktuara e cila mirëpërcaktohet, kufizohet në ligj.

Gjithashtu, nevoja për përfshirjen e autoriteteve civile erdhi dhe si pasojë e zgjerimit të subjekteve dhe parashikimit të masave për oficerët me grada madhore, siç janë gjeneralët, në përputhje me hierarkinë që këto autoritete kanë mbi këta oficerë me grada madhore. Këto autoritete civile kanë president, kryeministër, dhe ministër i Mbrojtjes. Është futur koncepti i rrethanave lehtësuese apo rënduese në ligj. Për herë të parë kemi futur këtë koncept. Ky koncept është huazuar nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ku janë përcaktuar rrethanat lehtësuese, mungesa e përvojës në punën e ushtarakut në Forcat e Armatosura, kryerja e shkeljes për herë të parë. Në sasi dhe rrethana rënduese është përcaktuar kryerja e shkeljes së disiplinës në publik, përsëritje të shkeljeve të disiplinës, vlerësime dhe rezultate jo të mira në punë.

E fundit gjë që dua të ndaj me ju është ankimimi administrativ. Në lidhje me ankimimin administrativ si rregull ai do të bëhet në çdo rast tek eprori direkt i autoritetit që e ka dhënë masën. Gjithsesi, edhe në këtë rast, për të shmangur çdo keqinterpretim të autoritetit ku mund të bëhet ankimimi, janë përcaktuar normalisht të gjitha shkallët dhe mënyrat se si ky ankimim do të bëhet. Për masat e dhëna për shkelje të rënda dhe shumë të rënda nga Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura dhe për masat e dhëna nga ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Presidenti i Republikës, është përcaktuar që ankimi të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatë. Një zgjidhje e tillë është menduar, pasi masat ndaj ushtarakëve të Forcave të Armatosura në këto raste jepen nga autoritetet më të larta në hierarkinë e drejtimit dhe të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura, siç janë shefi i shtabit, ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Presidenti dhe për pasojë ankimimi administrativ në një organ epror ndaj tyre nuk do të kishte kuptim. Ndaj dhe është lënë që ankimimi të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatë. Mendoj se kjo është një zgjidhje e përshtatshme, për sa i përket të drejtës së ushtarakëve për t'u ankimuar ndaj

vendimeve të marra në raport me ta, por gjithsesi jam e hapur në përfundim të fjalës sime për çdo koment dhe vlerësim tuajin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka relatori.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Të nderuar kolegë, që në fillim dua t'ju them se Komisioni i Ligjeve momentalisht është për dhënie mendimi, pasi komision përgjegjës është Komisioni i Sigurisë. Ashtu siç e përmendi dhe ministria e Mbrojtjes, projektligji i ardhur për shqyrtim në Kuvend vjen në kuadër të reformave të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO, ku përveç angazhimeve të shumta sjell nevojën për ndryshim dhe në forcimin e disiplinës në Forcat e Armatosura.

Projektligji ka për qëllim forcimin e disiplinës ushtarake, të rendit ushtarak dhe të autoritetit të komandimit, si dhe kontrollit të Forcave të Armatosura për të siguruar përmbushjen e misionit të tyre kushtetues. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe i rregullave të hollësishme të sjelljes të etikës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe kategoritë e shkeljeve të ndryshme që ndodhin në Forcat e Armatosura.

Projektligji parashikon autoritete përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore ndaj ushtarakëve, llojet e shkeljeve, masat e dhëna prej tyre, deri në saktësimin e autoriteteve përgjegjëse për dhënien, si dhe procedurat që duhen ndjekur për t'i proceduar këto masa.

Po ashtu projektligji parashikon edhe të drejtat ushtarake, në rastet e procedimeve disiplinore, si dhe të drejtën për vënien në dijeni me shkrim për elementet e procedimit disiplinor të nisur ndaj së drejtës, e drejtë e cila i kërkon dhe është domosdoshmëri për t'u dëgjuar edhe nga komisioni i ngritur drejtpërdrejt, komisioni disiplinor që konstaton shkeljen. Ministria i përmendi, por unë në mënyrë konçize do të doja të përmendja disa drejtime kryesore, të cilët janë risi nisur nga rregullorja e vjetër që vjen në një format të ri, jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje. Është shumë e rëndësishme dhe vjen si risi në këtë draft detajimi i autoriteteve përgjegjëse për dhënien e masave disiplinore duke filluar nga Presidenti i Republikës në cilësinë e Komandantit të

Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kryeministri të Republikës, ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm duke zbritur deri te komandanti i batalionit.

Së dyti, po të shikohet në tërësi, gjë për të cilën unë kam rezervat e mia edhe kur të diskutohet nen për nen, është rritur numri i masave disiplinore në krahasim me rregulloren e mëparshme gati në dyfish.

Së treti, një risi tjetër në këtë draft është se në lidhje me masat disiplinore ato janë ndarë në 3 kategori; në kategori të lehta, të rënda dhe shumë të rënda. Për dy llojet e para kanë qenë të parashikuar dhe në rregulloren e vjetër, ndërsa shumë të rënda është vendosur në këtë projektligj.

Si përfundim, të nderuar kolegë, duke e parë në tërësi të gjithë projektligjin, në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa në aspektin procedural po ashtu është paraqitur në përputhje me rregulloren e Kuvendit. Mendoj dhe propozoj që ky projektligj, pavarësisht ndërhyrjeve që do të kemi zonja ministre dhe zoti kryetar nen për nen, mendoj se duhet të miratohet pasi shërben drejtpërdrejt për rritjen e disiplinës në Forcat e Armatosura.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Falënderoj ministren që na dha një ekspozë!

Dua thjesht të bëj një koment. Më bëri përshtypje, zonja ministre, fjala që thatë ju për ligjin nr.9183, i 10 vjetëve më parë. Ju po bëni një ligj të ri dhe shumë mirë që po e bëni. Ajo që më kënaq mua është një ligj që është bërë më shumë në formën e rregullores. Pra, do të ishte mirë mbase që këto që tha relatori, në fund atë që përmendët dhe ju në fjalën tuaj si risi të reja që sjell ky projektligj i ri në raport me ligjin nr.9183 të ishin vënë standard dhe pjesa tjetër pastaj e shumë neneve që janë këtu për disiplinën dhe për format e tjera mbase duheshin bërë ose me VKM, madje kështu siç është shkruar për shembull, neni 10 zoti kryetar ka 51 pika. Është më shumë e afrueshme me një urdhër të brendshëm të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, pra me një rregullore të themi të forcave tuaja për të, sesa me një ligj apo me dhe me vendim qeverie. Pse e them këtë? E them këtë sepse në masat dhe në ndalimet e përgjithshme për ushtarakun vërtet ne kemi

parashikuar nenin 10 dhe 51 çështje të caktuara, por kush më thotë mua se mund të mos ketë një çështje 52, 53, 54, apo ndonjë nga këto që është jashtë mode, siç thatë dhe ju që ka dalë ligji për shembull që të mos pihet duhani në ambiente publike, nuk ka pse vihet këtu. Ndërkohë që ne ia lidhim duart vetes duke e vënë në ligj, kur duam të bëjmë një ndryshim nesër, apo dhe me vendim qeverie, ndërkohë që kjo mund të jetë një rregullore e brendshme e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për Forcat e Armatosura.

Pra, pyetja dhe sugjerimi që unë kam në tërësi, duke mos pasur vërejtje për projektligjin, mos duhet riparë më tepër, ia bëj sugjerim edhe Komisionit të Sigurisë, që është komisioni përgjegjës që disa nga nenet e tyre të reduktohen, në kuadrin e një ligji të mirëfilltë dhe pastaj pjesa e vendimeve të qeverisë apo të urdhrave që nxirrni juve, Unë jam shumë dakord me 3-4 njësi të reja. Dhënia e masave disiplinore nga ministri i Mbrojtjes, nga Kryeministri, nga Presidenti apo zgjerimi i subjekteve për të futur në këtë projektligj, apo dhe shumë elemente të tjera që janë në kompetencat lehtësuese. Pra, këto të evidentohen si nene dhe të bëhet një ligj më i thjeshtë jo me 27 nene, por mbase dhe më pak, dhe pjesën e detajuar le të themi të ketë vendime qeverie dhe urdhra të brendshme të ministrit të Mbrojtjes, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Unë për shembull kam ngritur shumë pikëpyetje te neni 10. Të merren deputetët me 51 raste të shkeljeve disiplinore, jam dakord, është për kulturën tonë që t'i lexojmë dhe të themi dakord, por në fund të fundit unë dua të di që ju në praktikën tuaj të përditshme mund të keni raste të tjera. Apo të merremi ne me nenin 11 për të klasifikuar, rrezikuar këto shkelje disiplinore të lehta, jo të lehta, e kështu me radhë? Këto janë çështje që ne e themi në ligj, që do të ketë klasifikim në shkeljen e masave disiplinore. Pastaj se si dhe çfarë mase janë ato janë çështje profesionale që ju takojnë juve, i takojnë shefit të Shtabit të Përgjithshëm, të takojnë ty si ministre, nuk na takojnë neve si deputetë që t'i bëjmë të detajuara. Kjo ishte me pak fjalë dhe sugjerim dhe vërejtje që kam që mund ta korrigjojmë edhe kur të vijmë nen për nen.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja ministre.

Mimi Kodheli -Unë ju falënderoj, zoti Fino, për sugjerimin dhe e konsideroj absolutisht të drejtë jo vetëm mënyrën se si e paraqisni atë, komentin tuaj, por edhe arsyen nga e cila niset ky gjykim juaji.

Po, ndaj të njëjtin mendim me ju. Ne në fakt jemi munduar t'i mbetemi deri diku besnik ligjit të vjetër, i cili i kishte të listuara këto arsye dhe flasim konkretisht për nenin 10, të cilat konsiderohen shkelje të disiplinës. Rrugës ne mund të gjejmë edhe shkelje disiplinore të tjera të cilat duke mos qenë në ligj do të ishin shkelje disiplinore, por bazuar në ligj nuk do të përbënin dot shkelje disiplinore. Pra, është një gjë e lëvizshme, është një gjë në dinamikë, jo domosdoshmërisht duhet të përcaktohet në ligj. Dinamika pa dyshim që ka një urdhër të brendshëm të ministrit, pa dyshim që ka një urdhër të brendshëm të shefit të shtabit, shumë më tepër nga çka një ligj, i cili dinamikën e ka të shtrirë në kohë. Kështu që jam plotësisht dakord që t'i rikthehemi diskutimit të nenit 10. Ndoshta këtë do të na duhet ta bëjmë gjatë diskutimit që do të kemi në Komisionin e Sigurisë dhe të Mbrojtjes kur të diskutojmë nen për nen, por parimisht jam dakord me vërejtjen tuaj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Zonja Ministre,

Në të gjitha ushtritë, natyrisht edhe në ushtritë e NATO-s, kërkohet rregull dhe disiplinë. A ka një model që ju i jeni referuar konkretisht për të hartuar këtë projekt-rregullore të disiplinës?

Mimi Kodheli – Në fakt, t'ju them të drejtën, zoti Qefalia, shumë nga ushtritë e vendeve aleate e kanë më të fortë ligjin për disiplinën dhe rregullat e brendshme, por shumë herë më të fortë. Ne jemi munduar të gjejmë një të mesme midis disa rregulloreve dhe disa ligjeve të disa vendeve në NATO. Ju siguroj që në momentin që sjellim një draft, një projektligj këtu, kemi marrë parasysh legjislacionin e shumë vendeve të tjera aleate apo të ngjashme me rregulloret dhe legjislacionin shqiptar. Por besomëni kjo është një ndër rregulloret më komode dhe ligjet më komode të disiplinës, në një kohë që në shumë vende të tjera, duke filluar që nga rregulloret dhe ligji i ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe deri të ngjashmet tona, siç mund të jetë ajo kroate, ka një sistem disiplinimi disa herë më rigid sesa ky që ne po ju paraqesim. Ne mendojmë se gjërat për 10 vjet kanë evoluuar. Është dashur të silllet kjo risi në ndryshimin e ligjit. Pra, të sjellim disa kufizime të tjera dhe besoj se kemi bërë më të mirën. Nëse doni që ne t'i

referohemi në mënyrë eksplicite legjislacionit të disa vendeve të tjera, mund ta bëjmë dhe t’jua sjellim pa problem.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Dakord.

Faleminderit!

E mbyllim këtu këtë çështje meqenëse janë edhe dy çështje të tjera dhe zonja Ministre besoj ka angazhime të tjera.

Zonja Ministre, faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.12.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Votimi në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri dhe Eduard Halimi

Të ftuar:

Mitat Tola - Drejtor i Policisë Rrugore, Ministria e Brendëshme

Nikolin Berxhiku – specialist në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Eni Çuli – specialist në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin tjetër, me ndryshimin në Kodin Rrugor.

Kemi mbetur te një dispozitë që do ta prezantojë relatori. Ka ardhur një propozim, por relatori ka bërë një reflektim pas konsultave dhe do ta paraqesë.

Zoti Muçmataj, urdhëroni!

Vexhi Muçmataj – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sot ne diskutojmë një propozim të Ministrisë së Brendshme për të ndryshuar nenin 144. Ky nen është diskutuar më parë edhe në Komisionin e Ligjeve, edhe në Komisionin e Sigurisë. Kolegët deputetë kanë diskutuar rreth këtyre ndryshimeve të propozuara dhe ne sot vijmë me një vlerësim dhe reflektim tjetër duke ulur masat e gjobave të propozuara, duke i përshtatur ato me nivelin ekonomik të drejtuesve të mjeteve në veçanti dhe nivelin ekonomik në përgjithësi të shtetasve shqiptarë.

Ndryshimet që ne propozojmë dhe shtesat në nenin 144 janë:

Në pikën 2 fjalët “nga 1 mijë deri në 3 mijë lekë” zëvendësohen “ nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë”.

Në pikën 3 ndryshohet si vijon: “Drejtuesi i mjetit që vazhdon lëvizjen ndonëse sinjalizimi i semaforit ose i policit të trafikut e ndalojnë këtë lëvizje, ndëshkohet me masa administrative me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.”

Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Cilido drejtues mjeti që përsërit brenda dy vjetëve më shumë se dy herë shkeljen e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, përveç masës me gjobë të parashikuar në këtë pikë, ndaj tij merret edhe masa administrative e pezullimit të lejes së drejtimit nga 9 muaj deri në 12 muaj”

Qëllimi i këtyre ndryshimeve është rritja dhe forcimi i efektit parandalues ndaj shkeljeve dhe shkelësve. Dihet sipas statistikave që nga shkeljet kanë ardhur dhe vijnë pasoja shumë të rënda për jetën, për shëndetin dhe pasurinë e shtetasve. Nisur nga ky qëllim ne propozojmë që këto ndryshime të miratohen në këtë seancë dhe t’i kalojmë në seancën plenare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Komisioni përgjegjës për këtë projekt është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, por meqenëse është këtu ky propozim duhet të japim një koment.

Ministria e Brendshme, bie dakord?

Mitat Tola – Drejtor i Policisë Rrugore. Në fakt, unë do të doja që paragrafi 2 të modifikohej. Masa që keni propozuar është 10-fish në raport me masën aktuale.

Paragrafi dy lidhet me një shkelje të themi të sinjalizimit rrugor jo të qenësishëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Sa është?

Mitat Tola – Është 10 deri në 30 mijë lekë, aktualisht. E keni bërë 100 deri në 300 mijë lekë të vjetra.

Fatmir Xhafaj – Sa e keni?

Mitat Tola – Aktualisht, është 10 deri në 30 mijë lekë të vjetra.

Fatmir Xhafaj – Është shkruar gabim.

Mitat Tola – Dakord. Korrigjimi i dytë që dua të bëj është: “Cilido drejtues mjeti që përsërit brenda dy vjetëve më shumë se dy herë...”, e ndërlikon shumë.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Mitat Tola – Brenda dy vjetëve, një herë, herën e dytë. Dy herë...

Fatmir Xhafaj – Pse kodi italian i specializuar...

Mitat Tola - E kam Kodin Rrugor italian...

Fatmir Xhafaj – “Cilido që përsërit brenda dy vjetëve shkeljen e parashikuar në paragrafin 3, për të paktën 2 herë, brenda dy vjetëve përveç masës me gjobë...”. Është kështu apo jo?

Mitat Tola – Po, përsëri shkojmë drejt një rëndimi të qytetarëve. Masa e propozuar nga ana jonë është ta lehtësojmë këtë normë, që është shumë e rëndë pezullimin e lejes së drejtimit, heqja për 6 muaj deri në një vit, recitivist quhet edhe me një herë. Propozimi ynë ka qenë: “Cilido që brenda një viti e përsërit të njëjtën shkelje...”

Fatmir Xhafaj – Ne themi dy. Ju thoni një. Ne themi të paktën dy herë që t'i heqësh patentën.

Mitat Tola – Brenda dy vjetëve?

Fatmir Xhafaj – Po, brenda dy vjetëve.

Mitat Tola – Rëndohet drejtuesi i mjetit.

Fatmir Xhafaj – Po ne nuk kemi semaforë në rrugë ende...

Dakord me ndërhyrjen tuaj të parë biem dakord. Ishte një keqkuptim.

Jemi dakord me propozimin e relatorit? Dakord.

Faleminderit!

Jemi dakord edhe në tërësi? Dakord.

Faleminderit!

Shumë faleminderit të gjithëve! I morëm shënim edhe propozimet tuaja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.12.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri dhe Eduard Halimi

Të ftuar:

Merita Xhafaj- drejtore e përgjithshme e politikave sociale.

Denada Seferi- drejtoreshë e përkujdesit shoqëror në Ministrinë e Miëqenies Sociale dhe Rinisë.

Dritan Danko- këshilltar për marrëdhëniet me parlamentin në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Fatmir Xhafaj - Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në projektligjin “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”.

Të ftuar në këtë komision janë: Zonja Merita Xhafaj, drejtore e përgjithshme e politikave sociale; zonja Denada Seferi, drejtoreshë e përkujdesit shoqëror në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe zoti Dritan Danko, këshilltar për marrëdhëniet me parlamentin në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ju lutem, një përmbledhje të vogël për sa i përket projektit, që të bëjmë edhe ne në fund komentet tona për komisionin përgjegjës.

Zonja Xhafaj, urdhëroni!

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Profesioni i punonjësit social është në procesin e njohjes si profesion i rregulluar në ligjin nr. 10171 datë 22.10.2009, “Për profesionet e rreguluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Shërbimi i punës sociale promovon ndryshimet shoqërore, zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet njerëzore, fuqizimin dhe lirinë e njerëzve për të rritur mirëqenien.

Ky shërbim vjen si një shërbim i domosdoshëm profesionistësh në kushtet kur problemet sociale, ndryshimet, tranzicionet dhe kompleksiteti i çështjeve sociale kërkojnë më tepër specializim dhe profesionalizëm në punën me individin, komunitetin, sistemin e përkujdesjes shoqërore dhe më gjerë me sistemet tjera.

Punonjësit socialë janë profesionistë, që punojnë në praktikë për të ndihmuar individët dhe familjet për të rivendosur apo për të rritur kapacitetin e tyre për funksionimin social, si dhe për të krijuar kushte shoqërore që mbështesin komunitetet në nevojë.

Ky shërbim ka njohur ndryshime cilësore përgjatë 20 vjetëve. Kjo u dedikohet, në radhë të parë, reformave të ndërmarra nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe nismave të vetë profesionistëve të fushës gjatë këtyre viteve.

Shërbimet sociale në periudhën e fundit janë duke përjetuar ndryshime të mëdha si decentralizimi dhe deinstitutionalizimi, procese të cilat imponojnë sfida për përfshirjen e punonjësve socialë, si figura profesionale shumë të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve sociale.

Punonjësi social është profili qendror në sistemin e përkujdesjes shoqërore. Ky profil zë vend të rëndësishëm në fusha të tjera, si ajo e drejtësisë, arsimit, shëndetësisë, praktikës private, shoqërisë civile etj.

Në kontekstin e reformës së shërbimeve sociale dhe ofrimit të shërbimeve të integruara, synimi kryesor është integrimi i profesionistëve të punës sociale në sistemin e mirëqenies sociale, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor. Pranë Universitetit të Tiranës, për herë të parë në vendin tonë, në vitin '92 është ngritur Fakulteti i Shkencave Sociale, ku bën pjesë edhe departamenti i punës sociale. Kapaciteti i këtij fakulteti është 1200 studentë në vit, ku diplomohen 400 studentë në nivelin bachelor dhe 300 studentë në nivelin master. Po kështu degë të tjera janë hapur edhe në qytete të ndryshme.

Reformat e ndërmarra kërkojnë krijimin e një urdhri të veçantë të punonjësve socialë për të kontrolluar dhe disiplinuar këtë profesion, pasi është një profesion që ushtrohet drejtpërdrejtë me përftuesit. Kjo praktikë dhe profesioni i punonjësit social tashmë është i konsoliduar në vendet e Europës Perëndimore dhe përbën një standard në ofrimin e shërbimeve cilësore të përkujdesit shoqëror.

Njëkohësisht, kjo përvojë është maturuar edhe në shumë vende të Europës Juglindore si: Kroaci, Slloveni, Maqedoni, Rumani, Bullgari, si dhe në shtetet e pavarura të ish- Bashkimit Sovjetik.

Objektivi kryesor i këtij projektligji është rregullimi i marrëdhënieve të këtyre profesionistëve jo vetëm kundrejt shtetit, por edhe për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë nga ushtrimi joetik dhe abuziv i profesionit të punonjësit social dhe profileve të tjera që kanë lidhje me të.

Ky projektligj bën të mundur delegimin e kompetencave për dhënien e së drejtës së ushtrimit të profesionit të punonjësit social nga profesionistë me përvojë, të konsoliduar dhe me kontribut cilësor në fushën e punës sociale dhe edukimit në vazhdim në ngritjen e këtyre profesioneve.

Urdhri është një hap i parë në institucionalizimin e profesionit dhe do të shoqërohet edhe me masa të mëtijshme, edhe me ndërhyrje në kuadër të reformës së shërbimeve shoqërore. Ky urdhër vjen në kohën e duhur, pas rreth dy dekada përpjekjesh

të vetë profesionistëve të fushës së punës sociale për të krijuar, konsoliduar dhe profilizuar këtë profesionin në kontekstin lokal të Shqipërisë.

Realisht, ky projektligj është diskutuar edhe në Komisionin e Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë. Ne kemi reflektuar të gjitha komentet dhe vërejtjet e bëra nga ky komision. Është diskutuar dhe dakordësuar edhe me shoqërinë civile, edhe me grupet e interesit dhe ka qenë një procedurë e gjatë për të cilën unë do të falënderoja të gjitha palët që kanë dhënë kontributin e tyre, sepse, për herë të parë, ne e kërkojmë të profilizojmë një profesion të tillë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Xhafaj!

Relatori, zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni i Ligjeve është caktuar si komision për dhënie mendimi në diskutimin e këtij projektligji. Komisioni i Ligjeve shqyrton këtë projektligj për moszbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit dhe ka për detyrë të vlerësojë bazën kushtetuese dhe procedurale të këtij projektligji.

Rezulton se nga pikëpamja kushtetuese projektligji “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, është në respekt të neneve 78, 81 dhe 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ndërsa, në aspektin procedural projektligji ka respektuar Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit u relatua pranë komisionit nga përfaqësuesit e ministrisë. Është normale që ky projektligj vjen pas miratimit të ligjit nr. 90 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku listës së profesioneve të rregulluara iu shtua edhe profesioni i punonjësit social dhe natyrshëm sot vjen për miratim projektligji “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas relacionit, ky projektligj ka si për objektiv rregullimin e marrëdhënieve të punonjësve socialë jo vetëm kundrejt shtetit, por edhe mbrojtjen e individit dhe të shoqërisë nga ushtrimi joetik dhe abuziv i profesionit të punonjësit social.

Urdhri është hapi i parë në institucionalizimin e këtij profesioni dhe në të ardhmen duhet të shoqërohet edhe me masa të mtejshme në kuadrin e një reforme tërësore të shërbimeve shoqërore.

Projektligji nga pikëpamja tekniko-legjislative ka respektuar formën dhe përmbajtjen që duhet të ketë një projektligj në hartimin e tij. Kështu rezulton që projektligji është i ndarë në 4 krerë:

Në kreun e parë parashikon dispozitat e përgjithshme ku jepen qëllimi, fusha e zbatimit dhe përkufizimet që ka projektligji.

Në kreun e dytë është parashikuar statusi i urdhrit si një ent publik jobuxhetor i pavarur, si dhe burimet financiare, po ashtu urdhri administron vetë buxhetin e tij në përputhje me rregullat financiare dhe të vetëfinancimit.

Në kreun e tretë është përcaktuar mënyra e organizimit dhe e drejtimit të urdhrit, organet drejtuese të urdhrit ku do të jenë asambleja, bordi, kryetari i urdhrit dhe kryetari i gjykit disiplinor profesional, duke parashtruar edhe mënyrën e zgjedhjes së këtyre organeve drejtuese të urdhrit.

Ndërsa, në kreun e 4 janë parashikuar dispozita kalimtare në bazë të të cilave ministria duhet të ngrejë një komision të përkohshëm për mbledhjen e asamblesë së urdhrit deri në ngritjen e funksionimit të bordit të këtij urdhri.

Siç u theksua edhe nga relatorët, ka eksperiencë ndërkombëtare në këtë fushë dhe Shqipëria u bashkohet vendeve të Europës Juglindore, si: Kroacia, Maqedonia, Sllovenia, Rumania dhe Bullgaria.

Si përfundim, projektligji nga pikëpamja kushtuese dhe procedurale ka respektuar të gjitha si në formë, ashtu edhe në përmbajtje reflektimet ato që kërkon Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit.

Projektligji kur të vijë ka pasur disa probleme në nene të caktuara të tij, por pas konsultave paraprake midis meje, si relator i caktuar nga Komisioni i Ligjeve dhe përfaqësuesve të ministrisë, janë reflektuar disa nga sugjerimet tona, që kanë të bëjnë më tepër të karakterit të teknikës legjislative rezulton se janë reflektuar dhe siç u parashtrua edhe këtu sugjerimet tona janë reflektuar.

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë në parim këtë projektligj dhe t'ia kalojmë seancës plenare për votim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Ka pyetje?

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj përfaqësuesit e qeverisë, si dhe relatorin për informimin, por unë kam disa pyetje për të cilat nuk gjej përgjigje në këtë projektligj.

Unë nuk i kam parë ndryshimet e mundshme që kanë bërë komisionet përkatëse.

Së pari, në projektligj nuk shikoj kriteret e licencimit të punonjësit social. Nuk parashikohen në këtë projektligj. Realisht duhet të parashikohen kriteret. Pra, ne nxjerrim urdhrin dhe nuk kemi kriteret.

Së dytë, në projektligj, te kompetencat e urdhrit për të pasur listat e punonjësve të specializuar socialë, kjo gjë nuk parashikohet. Për shembull: drejtësia, meqë jemi komision ligjesh, duhet ta thoshte edhe relatori, pjesëmarrje në gjyqe, pjesëmarrje në burgje, në arsim, në shëndetësi, në punët e brendshme. Pra, duhet të ketë punonjës të specializuar, mendoj unë, gjë e cila në projektligj nuk shihet.

Në projektligj nuk përcaktohen, për mendimin tim, as kriteret e specializuara. Për shembull: A është i mjaftueshëm niveli, siç thatë ju, 3-vjeçar, për punonjës socialë në fushën e drejtësisë? Është i mjaftueshëm niveli 3-vjeçar? Këtu dua një përgjigje dhe ligji për këtë punë është. Nuk është ligji thjesht për të bërë asamblenë e urdhrit, për të bërë bordin dhe për të parë se çfarë kompetencash ka kryetari i bordit. Ato po e po, por duhet të japë parimet bazë.

Pyetja tjetër që kam: Më vjen keq, te në neni 7, pika 8 e ligjit ka fuqi prapavepruese dhe ne si Komision i Ligjeve duhet ta korrigjojmë, sepse nuk mund ta miratojmë, do të hiqet. Ajo që më shqetëson dhe që e kam si pyetje të veçantë, për të cilën dua një përgjigje nga qeveria, është se në projektligj, zoti kryetar, mungon organizimi i urdhrit në nivel vendor. A do të ketë një organizim të tillë në nivel vendor, a s'do të ketë? Apo thjesht e krijojmë këtu lart dhe, boll ta kemi këtu, se pastaj s'ka rëndësi çfarë bëhet me bashkitë e komunat.

E fundit fare që kam – pak a shumë e tha edhe relatori – është se edhe ky projektligj, zoti kryetar, po ta marrësh e ta shikosh me kujdes, dhe unë e kam lexuar me kujdes dhe, më ngjan më shumë si një rregullore, sesa me një projektligj të mirëfilltë. Ne e kemi për detyrë, si Komision Ligjesh, që t'ia heqim atë gjënë e tepërt që kanë ligjet në përgjithësi, kur mundohemi të vëmë çdo gjë në mënyrë të sanksionuar. Sepse një ligj

bëhet me 5-6 nene kryesore, pastaj janë aktet nënligjore që e përmbushin atë, qoftë vendimet e qeverisë, qoftë urdhrat e ministrit në kuptimin e tyre, apo qoftë dhe vetë rregullorja e bordit apo e kryetarit të asamblesë... Pra, ata kanë rregulloret e tyre. Nuk mund t'ua miratojmë ne rregulloret në parlament, me ligj, kur ata janë një asamble, që mbledhen vetë sa herë në vit, që kanë një rregullore të tyre, qoftë bordi apo qoftë dhe kryetari i urdhrit të punonjësit social.

Këto janë ca vërejtje që mund t'i bëjmë edhe kur t'i shikojmë nen për nen, të cilat, unë nuk e di, ndaj thashë, mund të kenë bërë komisionet e tjera, kryetar, e mbase unë jam pak i vonuar, por me këtë projektligj që kam përpara më rezulton se është më shumë se ç'duhet i punuar në formën e një rregulloreje, vendim qeverie, se sa ligji. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino! Nga Ministria ka ndonjë koment?

Merita Xhafaj – Faleminderit për pyetjet, por edhe për komentet njëkohësisht! Realisht, lidhur me kriteret e licencimit të punonjësve socialë, është neni 7: “Janë anëtarë të urdhrit të punonjësit socialë të gjithë punonjësit socialë që përmbushin kriteret e mëposhtme: të jenë shtetas shqiptar, të kenë diplomën në degën e punës sociale, kërkesat minimale për formimin dhe kualifikimin profesional për punonjësit socialë përcaktohen me vendim.” Janë të parashikuara.

Në fakt, mbase ju keni variantin e vjetër të ardhur nga Këshilli i Ministrave. Janë bërë një sërë rregullimesh në nenet respektive, bazuar edhe në diskutimin që ne kemi pasur me relatorin.

Fatmir Xhafaj – Pavarësisht nga kjo, ne si praktikë, ju e dini, ne punojmë mbi draftin e ardhur nga Këshilli i Ministrave. Në fund fare pastaj, seancës i vete me vërejtje. Kështu që, ju duhet të përgjigjeni për atë, sepse, e tha relatori, që keni bërë një diskutim paraprak, e kjo është pozitive për të sqaruar, për ta lehtësuar procesin, por pastaj debati dhe vendimmarrja janë këtu.

Merita Xhafaj – Për sa i takon modelit, është parashikuar se do të bëhet, do të përpilohet edhe rregullorja, edhe statuti, por realisht ky format i këtij projektligji është një format i cili është zbatuar edhe në shtete të tjera, pore dhe në formatin e Urdhrave respektivë, si Urdhri i Mjekut apo urdhra të profileve të tjera, që kanë një urdhër. Kështu

që, standardi është i njëjtë. Ne nuk kemi devijuar nga ky standard, po përkundrazi, jemi munduar të ruajmë formën, pavarësisht se brenda në përmbajtje ka specifikat e veta.

Për sa u takon listave, e dhe ato do të jenë të parashikuara në rregulloren e brendshme, ndërsa sa i takon shtrirjes në nivel qendror dhe në nivel vendor, ne e kemi parashikuar dhe është e reflektuar në ndryshimet që janë bërë më pas, me vërejtjet e rekomandimet e Komisionit të Çështjeve Sociale e të Shëndetësisë, dhe është parashikuar që të shtrihet në nivel rajonal. Kështu që, disa nga këto pyetje dhe komente që ju bëtë realisht dhe që mua më duken shumë të drejta, janë të reflektuara, për të mos thënë që të gjitha komentet tuaja.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Faleminderit!

Zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua ta përgëzoj Ministrinë për këtë nismë dhe për rregullimin e profesionit të punonjësit social, por kam një pyetje lidhur me përkufizimin që i keni dhënë punës sociale. Më duket shumë e gjerë, hera-herës edhe kontradiktore po të kemi parasysh që në një nen të mëpasshëm të ligjit, pikërisht te neni 8, ju thoni se “asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesione të tjera të punës sociale”.

Sa profesione të punës sociale ka?

Pyetja e dytë: Rimarr shqetësimin që ngriti zoti Fino lidhur me regjistrat e posaçëm. Ju kërkoni që Urdhri i punonjësit social të krijojë regjistrin e punonjësve socialë, pra të urdhrit, regjistrin e përgjithshëm, krijimin e regjistrit të posaçëm të administratorit shoqëror. Administratori shoqëror është rregulluar me një ligj tjetër, që ka të bëjë me ndihmën ekonomike. Dua të di nëse administratori shoqëror do të jetë punonjës social? Duhet të ketë kualifikimin e punonjësit social? Duhet të regjistrohet? Nëse po, a do të rregullohet dhe ligji tjetër, pra ligji që ka të bëjë pikërisht me ndihmën dhe shërbimet sociale, që daton më 2005-en.

Gjithashtu, a do të krijoni regjistra të posaçëm për çdo fushë. Për shembull, punonjësit socialë që punojnë me njerëzit me aftësi të kufizuara, për familjet në nevojë, për drejtësinë, për burgjet. Unë mendoj se duhet dhe, nëse duhen përcaktuar në ligj kriteret që duhet të përmbushin personat. Ne kemi hapur një praktikë, – më fal zoti kryetar, që përveç pyetjes po bëj dhe një koment – ne kemi hapur në komision një

praktikë që, të gjithë personat që zgjidhen, qoftë në institucionet e pavarura kushtetuese, por edhe në administratë publike, nuk mund të zgjidhen në bazë të kriterëve super të përgjithshme, ku kushdo mund të fillojë punë pa pasur kualifikime. Pra, kemi parashikuar në ligj kriteret dhe kushtet e përgjithshme që duhet të përmbushë dhe disa kriterë ligjorë shtesë. Sugjeroj që në ligj të parashikohet që krahas arsimimit që mund të ketë një person, që mund të ketë arsimin për punonjës social, duhet të ketë profilizim; ai që punon në paraburgim, në burgje, ata që punojnë me persona të shëndetit mendor, ata që punojnë me fëmijët jetimë, ata që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, ata që punojnë me të huajt, e të tjerë. Kjo duhet të jetë shprehimisht në ligj.

Juve në fakt keni një kontradiktë. Në një pikë, te neni 6, ku flisni për misionin, nuk përmendni krijimin e regjistrave të posaçëm, ndërsa në nenin 7, te pika 5, thoni: individët e regjistruar në Urdhër, në regjistrat e posaçëm të profesioneve të tjera të punës sociale. Pra, kur thoni profesione të tjera të punës sociale, unë nuk arrij të kuptoj se sa profesione të tjera të punës sociale dhe për çfarë regjistrash bëni fjalë?

Prandaj në ligj sugjeroj që në nenin 6 të përcaktoni të paktën llojet e regjistrave bazë, si dhe kriteret që duhet të përmbushin personat për të punuar. E them këtë, zonja Xhafaj dhe zonja Denadë, sepse në gjykata po punojnë studentë që sapo kanë mbaruar, që nuk kanë përvojë dhe që e përdorin këtë mundësi vetëm për të marrë një të ardhur, por nuk mund të mbrojnë as të miturin, as gruan e dhunuar, sepse nuk kanë kualifikimet dhe specializimet.

Kam edhe një pyetje të fundit: a parashikoni që për këta persona të ketë një provim të veçantë? Pra, personat që do të punojnë, thjesht do të regjistrohen në Urdhrin e mbrojtjes? Nuk do të kenë ndonjë marrje licence, ku të kontrollohen dijet e përgjithshme dhe dijet e veçanta në fushën që duhet të ushtrojnë? Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Xhafaj.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, unë po e nis nga fundi, meqë më kujtohet kjo pyetje e licencimit, sepse është një nga çështjet kryesore që ne na intereson. Licencimi do të ketë një stad kalimi dhe testimi, por licenca do të jetë e përshkallëzuar. Nuk do të ketë një licencë të vetme për të gjitha kategoritë e punonjësve socialë. Kjo do të jetë e përshkallëzuar.

Për sa i takon pjesës së administratorëve shoqërorë, disa nga nenet që rrjedhin si pasojë e ekzistencës së variantit të parë, kur ishte përfshirë administratori shoqëror, janë për shkak të këtij fakti. Realisht, janë bërë ndryshimet përkatëse në riformulim të neneve, për shkak se është hequr nga ligji pozicioni i administratorit shoqëror. Nuk është më pjesë e këtij ligji.

Ne e kemi në vëmendje edhe rishikimin e ligjit 9355 “Për shërbimet sociale” dhe aty do të krijojmë një hapësirë të veçantë edhe për administratorët shoqërorë, natyrisht. Më shumë të drejtë, ju e trajtoni këtë lloj shqetësimi. Pastaj, një pjesë e kriterëve dhe e problematikave që ju trajtoni, nuk mund të përmbliidhen të gjitha në një ligj, kështu që pjesa e kriterëve lihet, edhe me vendim të Këshillit të Ministrave, për t’u trajtuar e për t’u parashikuar sipas specifikave përkatëse, sepse, natyrisht, kriteret bazë janë shkruar, e janë diplomimi...

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zonja Seferi.

Denada Seferi – Në fakt, tek përkufizimi kemi qenë dhe jemi ndeshur me debate jashtëzakonisht të gjera edhe me grupet e interesit, njëkohësisht edhe me Fakultetin e Shkencave Sociale, i cili është edhe organi kryesor që na ka dhënë një mbështetje edhe në hartimin e këtij projektligji. Është lënë një përkufizim i gjerë, në mënyrë që ne të kemi mundësi që, në rregulloren e brendshme e në statut të krijojmë edhe ato listat e posaçme, që përmendi edhe zoti Fino pak më parë, por njëkohësisht të krijojmë edhe në statut të gjithë profilizimet dhe profilet e përcaktuara të punonjësit social. Ashtu siç me të drejtë e ngritët ju, kemi të bëjmë me punonjës socialë në drejtësi, kemi të bëjmë me punonjës socialë në drejtësi, kemi të bëjmë me punonjës socialë në shërbime direkte, kemi të bëjmë me administratorin shoqëror, që në të vërtetë është një punonjës social dhe duhet të jetë një punonjës social, i cili ofron shërbimin direkt. Ndërkaq, të gjitha këto do t’i reflektojmë edhe në vendimet e Këshillit të Ministrave, por edhe në projektligj. Në fakt, ato shqetësime që ju ngritët janë të referuara dhe janë të rishikuara, domethënë për sa u përket profileve të ndryshme. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Relatori, kolegët e tjerë, kanë diçka për të shtuar? Në rregull, relatori atëherë.

Ulsi Manja – Zoti kryetar, të gjitha shqetësimet, pyetjet apo komentet e kolegëve, qoftë të zotit Fino, qoftë të koleges Hysi, janë ngritur edhe në konsultat tona paraprake dhe ne kemi pasur objeksionet tona në lidhje me nenin 3, kemi pasur objeksionet tona edhe me nenet 7 dhe 8, ku parashikohet fuqia prapavepruese që i jepet projektligji. Gjithashtu kemi pasur pretendimet tona edhe në lidhje me nenin 6, ku përcaktohet regjistri i posaçëm i administratorit shoqëror e të gjitha, por pas konsultave që kemi bërë me përfaqësuesit e Ministrisë së Mirëqenies Sociale, të gjitha këto vërejtje janë reflektuar në relacionin që rehatuan sot përfaqësuesit e Ministrisë dhe ne nuk e gjykuam të arsyeshme që të ndalemi specifikisht në diskutimin në parim të këtij projekti, sepse në diskutimin nen për nen, ndoshta do të shfaqen edhe ndryshimet që janë bërë.

Ajo që vlen të theksohet është se neni 3, për shembull, pas konsultave paraprake është hequr komplet nga projektligji, sepse përkufizimet e sjella në nenin 3, qoftë për kategorinë kush do të konsiderohet punë sociale, punonjës social dhe cili do të ishte profili i administratorit shoqëror, e ngushtonin së tepërmi rrezen e kësaj kategorie të punonjësve që do të ofrojnë shërbime sociale. Konkretisht edhe unë i bashkohem shqetësimit të koleges Hysi, që profili i administratorit shoqëror, ose ata që sot rëndom quhen punonjës që shpërndajnë ndihmën ekonomike nëpër organet e pushtetit vendor, apo ndihmën ekonomike për personat me aftësi të kufizuar, pensionistët e kështu me radhë, nuk mund të jetë një profil kaq i ulët. Nëse profilin e administratorit shoqëror do ta shohim dhe si një profil përkujdesjeje ndaj kësaj kategorie shoqërore, sepse qoftë personat që marrin ndihmë ekonomike, kemi të bëjmë me familje të varfra, të cilët në fund të fundit varfëria i çon edhe në probleme të rënda sociale e psikike, po qoftë shpërndarja e ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuar, invalidët apo edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, është krejt i ligjshëm shqetësimi, që profili i këtij personi nuk duhet të jetë ky që është. Ju e dini tashmë, se ka raste që ky person është edhe me arsim tetëvjeçar. Arsimi i lartë shihet si luks në këtë lloj profesioni.

Unë jo vetëm që i bashkohem këtij shqetësimi, por edhe ju falënderoj ëpr mirëkuptimin për ta reflektuar këtë ndryshim lidhur me kategorinë e personit të administratorit shoqëror.

Me të drejtë u tha se regjistri i administratorit shoqëror do të përcaktohet me rregullore. Në këtë rregullore apo statut që do të ketë Urdhri, duhet të përcaktohet shumë

saktë profili i këtij punonjësi, madje ndoshta edhe më i precizuar se sa dy kategoritë e tjera, sepse kur flitet për punonjës social në drejtësi, në burgje apo në universitete apo më shkolla, është krejt normale që profili i këtij personi nuk mund të jetë profili i një personi me shkollë të mesme. Ndërkohë, ne kërkojmë me insistim që profili i administratorit shoqëror dhe regjistri i posaçëm të parashikohet në detaje, sepse ky është personi që është në kontakt të vazhdueshëm e në komunikim të vazhdueshëm me pjesën më të viktimizuar të shoqërisë. Ne flasim për 200 – 300 mijë familje që janë në skemën e ndihmës ekonomike, për persona me aftësi të kufizuar apo për fëmijë me probleme shëndetësore, ndërkohë që u ofrojmë një profil administratori shoqëror tepër të ulët. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po. faleminderit, zoti Manja!

Zonja Seferi, kishit ndonjë koment?

Denada Seferi – Pohoj shqetësimin dhe bie dakord me problemin e ngritur. Ndërkaq, regjistrat e posaçëm do t'i kemi të veçantë, domethënë edhe specifikimet, edhe profilet. Ndërkaq do të bëjmë një ligj të veçantë për shërbimet sociale, ku roli i administratorit shoqëror do të jetë kyç.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Seferi!

Bashkohem me shqetësimin e kolegëve, që për disa dispozita të këtij projektligji ka nevojë të ketë më shumë vëmendje gjatë shqyrtimit nën ëpr nën. Jo rastësisht, ky projektligj, në ndryshim nga urdhrat e tjerë, ka ardhur këtu në Komisionin e Ligjeve, ashtu siç do të vijë edhe Urdhri për Psikologun, sepse ka një ndërthurje të rëndësishme sot me shërbimet që ofron sistemi i drejtësisë. Është shumë i rëndësishëm për funksionin e sistemit, për funksionimin e drejtësisë në përgjithësi, në mënyrë të veçantë të aspektit social apo të rolit që ka psikologu në shumë vendimmarrje gjyqësore sot, ndaj dhe vëmendja që kërkohet për ta trajtuar këtë funksion dhe këtë rol që tashti, që në gjenezë, në përmbajtjen e këtij projekti që ka të bëjë me Urdhrin e Punonjësit Social, është shumë e rëndësishme.

Duke vlerësuar komentet e kolegëve, të cilat ishin dashamirëse për ta përmirësuar dhe për t' a mbajtur në konsideratë këtë këndvështrim tonin, si Komision i Çështjeve Ligjore, duke vlerësuar komentet që bëri relatori dhe duke mirëkuptuar faktin që ka pasur një diskutim paraprak ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë dhe relatorit lidhur me çështje të veçanta që trajton projekti, mendoj ta ndërpresim këtu. T'i japim

mundësi relatorit dhe këshilltarëve të komisionit, që së bashku me ekipin e Ministrisë, të mund t'i reflektojnë këto në përmbajtjen e dispozitave të projektit, në mënyrë që kur t'i diskutojmë nen për nen, të jetë shumë më e thjeshtë edhe për kolegët, të jetë debat më i koncentruar, në mënyrë që të mos bëjmë përsëritje apo të mos debatojmë për gjëra që tashmë kanë një mirëkuptim, një dakordësi për t'u trajtuar dhe zgjidhur.

A biem dakord me këtë logjikë, zonja Xhafaj?

Zonja Xhafaj – Po, shumë dakord! Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Atëherë do t'ju lutesha që, së bashku me zonjën Seferi e me të tjerët që janë të ngarkuar për këtë projekt, gjatë ditës së sotme, mundësisht nesër, të kontaktoni me relatorin, të përcaktoni ku janë ndryshimet dhe si reflektohen këto ndryshime në përmbajtjen e neneve respektive, në mënyrë që pastaj t'i hapim rrugë diskutimit nen për nen. Sepse, nëse nuk kalon këtu, nuk mund të kalojë në seancë, pavarësisht Komisionit të Çështjeve Sociale.

Dakord?

Dakord kolegët?

E mbyllim këtu. Faleminderit zonja të nderuara! Faleminderit, zoti Dango, që ishit këtu! Shpresoj të takohemi së shpejti në shqyrtimin nen për nen. Ndërkohë, mbledhemi nesër në orën 10:00, sipas rendit të ditës.

MBLEDHJA MBYLLET